



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE

Nr.172/3 prot.

Tiranë më 02.03.2020

## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (të ndryshuar), Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.3717/2, datë 01.02.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Shërbimeve Funerale, njësi në varësi të Bashkisë Tiranë” (të ndryshuar), Agjencia e Shërbimeve Funerale shpall procedurat e konkurimit për vendin e lire të punës për pozicionin:

### **1 (një) Specialist Inxhinier Ndërtimi – Kategoria e pagës III-b**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

- 1. Njeh dhe zbaton legjislacionin në fuqi të fushës së ndërtimit.*
- 2. Ndjek investimet që kryhen nga institucioni në varrezat publike, brenda territorit të Bashkisë Tiranë, sipas kushteve të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes.*
- 3. Harton dokumentacionin teknik dhe zbaton çdo kërkesë tjetër, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi të prokurimeve publike, me natyrë të fushës së ndërtimit.*
- 4. Shqyrton kërkesat teknike të propozuara nga sektorët e varrezave dhe 13 njësitë administrative për punime të domosdoshme apo emergjente në varrezat publike.*
- 5. Harton projekt-preventivat për punime të ndryshme që propozohen të kryhen nga sektorët e varrezave në përputhje me manualët e ndërtimit në fuqi.*
- 6. Kontrollon situacionet e raportimit të punës nga teknikët e ndërtimit Tufinë dhe Sharrë.*
- 7. Kontrollon raportet periodike dhe vjetore të punës në sektorët Tufinë dhe Sharrë.*
- 8. Rakordon punën me sektorin ekonomik për hartimin e zbrërthimit të përdorimit të materialit teknik.*
- 9. Kontrollon në mënyrë periodike zbatimin e ndërtimit të varrit sipas parametrave teknike vendosur në V.K.M nr.712, datë 29.10.2014 për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”.*

### **1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit për pozicionin specialist inxhinier ndërtimi janë:**

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë kryer arsimin e lartë;

- c) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- e) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) Të zotërojnë minimalisht diplomë të nivelit “Master Profesional” në Inxhinieri Ndërtimi;
- b) Të këtë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në profesion;
- c) Përdorues shumë i mirë i paketës MS Office dhe programet kompjuterike të fushës si autocad etj;

**2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
2. Curriculum Vitae (jetëshkrimi);
3. Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar (përfshirë edhe diplomën bachelor);
4. Fotokopje e kartës se identitetit;
5. Çertifikatë e përbërjes familjare;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
7. Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
8. Motivacioni i largimit nga puna e fundit (nëse është i punësuar ose ka qënë i punësuar);
9. Raport mjeko-ligjor;
10. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
11. Dy fotografi ( përmasa 2.5x3.5 cm)

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e protokollit të Agjencisë së Shërbimeve Funerale brenda datës **17 Mars 2020**.

**3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **20 Mars 2020**, Njësia e burimeve njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve Funerale do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Agjencisë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit për pozicionin e lirë të punës dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

**4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë në:

a- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

b- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar).

## **5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

## **6. DATA E DALJES SË REZULTATIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Agjencisë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut.